



## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Dokumentit me nr. 6694/1 prot., datë 29.12.2023, “Manuali i Burimeve Njerëzore të OST sh.a.”, si dhe Dokumentit me nr. 3329/2 prot., datë 28.05.2021, “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Njësitë Operative dhe Njësinë e Mirëmbajtje Transmetimit” (e rishikuar), OST sh.a. shpall procedurën e rekrutimit për pozicionin e mëposhtëm:

**Elektriçist Kryesor** në Sektorin e Shfrytëzimit, Njësia Operative Tiranë (NJOT)

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Duhet të njohë dhe zbatojë rregulloren e Sigurimit Teknik,
- Duhet të njohë dhe zbatojë Rregulloren e Shfrytëzimit për Impiantet, instalimet dhe paisjet elektrike,
- Rregulloren e mbrojtjes kundra zjarrit, etj;
- Pasi përgatitet për një periudhë kohore 1-2 mujore i nënshtrohet provimit për vend pune e sigurim teknik.
- Më pas kryen periudhën e dublimit prej 15 ditësh.

### **Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati për punësim:**

- Të ketë shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara;
- Të jetë i aftë për punë;
- Të mos jetë i dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë;
- Të gëzojë integritet moral dhe profesional, si dhe të mos jetë marrë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës;
- Të mos ketë lidhje familjare me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkie;
- Personat që kandidojnë për këtë pozicion, duhet të kenë të paktën 2 -vite eksperiencë pune në fusha relevante.



## **ARSIMI I KËRKUAR:**

I mesëm elektrik/ I mesëm me kualifikim të lartë elektrik

## **Dokumentat për dorëzim**

### **Faza e Vlerësimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Arkivë-Protokollit, në Aparatin Qendror të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose nëpërmjet postës elektronike: [info@ost.al](mailto:info@ost.al) këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (CV)
2. Dëftesë arsimit të mesëm/ Çertifikata të kualifikimeve profesionale
3. Çertifikime të tjera relevante

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së shoqërisë.

**Afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të bëhet brenda datës 31.03.2024.**

### **Mënyra e vlerësimit:**

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.



## **Dokumentat për dorëzim**

### **Faza e lidhjes së kontratës:**

1. Libreza e punës (nëse ka) ose vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore.
2. Fotokopje e noterizuar diplomës së bashku me listën e notave
3. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
4. Fotokopje ID
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga gjykata.
7. Vërtetim nga prokuroria.
8. Çertifikatë familjare
9. Dëshmi të ndryshme kualifikimi.

**###**